

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Lumni Sallauka - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.Q. nga fshati ... komuna e Glllogocit, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.H.B. nga Glllogoci, kundër të paditurës Komuna e Glllogocit – Drejtoria e Arsimit në Glllogoc, të cilën e përfaqëson e autorizuar N.K. nga Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë, për kompensimin e tri pagave me rastin e pensionimit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, C.nr.209/16, të datës 09.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14.06.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të autorizuarit të të paditurës Komuna e Glllogocit – Drejtoria e Arsimit në Glllogoc, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, C.nr.209/16, i datës 09.06.2017, **VËRTETOHET**, përveq pjesës për llogaritjen e kamatës e cila **NDRYSHOHET** dhe gjykohet ashtu që kamata do të llogaritet prej ditës së marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 09.06.2017, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.209/16, të datës 09.06.2017, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit F.Q. nga fshati ... komuna e Glllogocit si të bazuar dhe e ka detyruar të paditurën Komuna e Glllogocit që në emër të tri pagave të fundit me rastin e shkuarjes në pension t'i paguaj paditësit shumën prej 1.342.02 €, me kamatë prej 8% në vit duke filluar nga data 09.09.2016, kur paditësi ka parashtruar padi në gjykatë e deri në pagesën definitive si dhe e ka detyruar të paditurën t'ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 395 €, të gjitha këto detyrime në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kanosjen e përmbarimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi e autorizuar e të paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e goditur me këtë ankesë ta ndryshojë ose të njëjtën ta kthejë në rigjykim.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarës të të paditurës është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi F.Q. me datë 09.09.2016, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për pagesën përcjellëse të tri pagave mujore pas pensionimit kundër të paditurës Komuna e Gllogocit – Drejtoria e Arsimit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që t'ia paguaj paditësit pagesën përcjellëse në lartësi prej 3 pagave mujore që i ka marrë për tre muajt e fundit, përkatësisht nga 447.34 €, në muaj e në shumën totale për tre muaj 1.342.02 €, me kamatë ligjore, duke llogaritur atë nga data e pensionimit 15.06.2016, e deri në pagesën definitive. Gjithashtu ka kërkuar që e paditura t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimin me kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse, në seancë të shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.209/16, të datës 09.06.2017, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata ka theksuar se në cilësi të provave materiale ka administruar: kontratën e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës nr.181/30330 të datës 03.06.2016, kërkesën e paditësit parashtruar tek e paditura me datë 12.07.2016 dhe kërkesën e përsëritur të paditësit parashtruar tek e paditura me datë 30.08.2016.

Gjykata ka arsyetuar se nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësi ka punuar tek e paditura në shkollën fillore të mesme e ulët "7 Marsi", në fshatin ... komuna Gllogoc, në vendin e punës mësim klasor, fakt që vërtetohet nga kontrata e punës të mësimdhënies nr.571, të datës 30.10.2017, e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, po ashtu nga kjo kontratë vërtetohet se paditësi deri sa ka qenë duke punuar ka realizuar të ardhura mujore në lartësi prej 447.34 €. Gjithashtu ka shtuar se nuk ka qenë kontestuese se me vendimin nr.181-30330, të datës 03.06.2016, të lëshuar nga Drejtoria për Arsim në Gllogoc, paditësit i është pushuar marrëdhënia e punës me datë 15.06.2016, në bazë të fuqisë ligjore nga se ka mbushur moshën e pensionimit përkatësisht prej 65 viteve. Kontestuese ka qenë baza e kërkesëpadisë me theksim se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive, mes Ministrisë së Arsimit dhe Komunës së Gllogocit – Drejtorisë së Arsimit por kanë lidhur një marrëveshje që punëtorët e arsimit që pensionohen të u bëhet pagesa vetëm për një muaj pas pensionimit.

Lidhur me mënyrën e vendosjes si në pikën I të dispozitivit gjykata e shkallës së parë sa i përket pagesës së tri pagave përcjellëse i është referuar dispozitës së nenit 36 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar e lidhur me datë 11.04.2014, në mes të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës (MASHT-it) dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit Shkencës dhe Kulturës (SBASHK-ut), me të cilën parashihet se *"punëtorët (anëtarët e SHBAHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi prej tri pagave sipas mesatares se tri pagave të fundit të punëtorit*.

Gjykata ka shtuar se fillimisht edhe pse paditësi i është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin e këtyre pagave nuk ka marrë përgjigje nga e paditura dhe e ka përsëritur kërkesën e cila është e evidentuar tek e paditura me nr.09/120-50941, por e paditura nuk ka prezantuar gjatë shqyrtimit ndonjë provë se ka vendosur në kërkesat e paditësit. Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës por të njëjtat i refuzoi si të papabazuar për faktin se të njëjtat ishin në kundërshtim me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata ju ka referuar neneve 36 paragrafi 9, nën paragrafi 9.3 dhe 9.4, 36 paragrafi 9 nën paragrafi 9.4 dhe 9.5, të Kontratës Kolektive të Arsimit Para Universitar dhe nenit 52 dhe 53 të Kontratës Kolektive, e lidhur me datë 11.04.2014, në mes të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, (MASHT) dhe Sindikatës Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, (SBASHK), të cilat kontrata kanë hyrë në fuqi me date 01.01.2015.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të autorizuarit të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension me datë 15.06.2016, dhe se i njëjti ka përvojë pune si mësimdhënës mbi 43 vite. Përveç kësaj nuk ka qenë kontestuese as lartësia e pagave.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenin 90 paragraf. 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën*

Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.

Me nenin 53 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se “i punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt të fundit”. Me nenin 36 paragraf 9, të Kontratës Kolektive të datës 11.04.2014, përcaktohet se “punëtoret që dalin në pension përfshinë pensionin jubilar në vlerë: a) për 10 vjet të përvojës së punës të punëdhënës i fundit në vlerë të një page bazë, b) për 20 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të dy paga bazë, c) për 30 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave bazë, d) punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar dhe e) shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit në tërësi të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit t’i paguaj tri paga në emër të shpërblimit jubilar, me të drejtë është bazuar në nenin 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës e lidhur me datën 18.03.2014, dhe të nënshkruar nga organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), si dhe nenit 36 paragrafi 9 dhe 10, të Kontratës Kolektive e Arsimit Parauniversitar, e lidhur me datë 11.04.2014, në mes të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, (MASHT) dhe Sindikatës Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, (SBASHK), të cilat kontrata kanë hyrë në fuqi me date 01.01.2015, ndërsa paditësi ka dalë në pension më datë 15.06.2016, çka do të thotë se këto marrëveshje – kontrata kanë qenë në fuqi në momentin e pensionimit dhe se të njëjtat janë në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës, nga rrjedh themelësia e kërkesëpadisë.

Për kamatën gjykata ka vendosur në pajtim me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), nenit 382, por që sipas Gjykatës së Apelit, kamata duhet të llogaritet prej momentit të nxjerrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 09.06.2017, e deri në pagesën definitive.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3211/17, datë14.06.2018

**Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari,
Valon Totaj**